



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 223/4 Prot.

Tiranë, më 26.07.2021

VENDIM

Nr. 29, datë 22.07.2021

“Për miratimin e Udhëzuesit “Për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor, që financohen nga buxheti për kërkimin shkencor, në Universitetin e Tiranës”

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, germa “a”, neni 95, neni 108, neni 110, pika 1, germa “c” dhe neni 111; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, germa “cc”, neni 114 dhe neni 120, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 22.07.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit “Për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor, që financohen nga buxheti për kërkimin shkencor, në Universitetin e Tiranës”.
2. Udhëzuesi i Rektoratit, datë 17.06.2019 “Për miratimin e Udhëzuesit “Për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor, që financohen nga buxheti për kërkimin shkencor, në Universitetin e Tiranës”, shfuqizohet.
3. Vendimi t’i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës.
4. Vendimi t’i përcillet të gjitha njësisve përbërëse të Universitetit të Tiranës, pasi të jetë shprehur Bordi i Administrimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Dr. Artan Hoxha



**THIRRJE PËR PROJEKTE NË PROGRAMIN “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE
INOVACION”**

Thirrja është e hapur deri më 15 tetor 2021, ora 17:00

Tiranë, 2021

***Shënim:** Ky dokument përfshin kornizën e përgjithshme referuese në paraqitjen e projekt propozimeve nën këtë thirrje.*

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në këtë aplikim.

Përmbajtja

1	Informacion i Përgjithshëm	3
2	Qëllimi dhe Objektivat e Programit “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”	3
3	Kriteret e Aplikimit	4
4	Financimi dhe Udhëzime mbi Buxhetin.....	4
5	Afati i Aplikimit dhe Dorëzimi	5
6	Procedurat e Përzgjedhjes dhe Kriteret e Vlerësimit.....	6
7	Zbatimi dhe Monitorimi i Projekteve.....	7
Anekset - eform		9
Aneksi 1: FORMULARI I APLIKIMIT NË PROGRAMIN “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION”		9
Aneksi 2: FORMULARI I BUXHETIT		15
Aneksi 3 ARSYETIMI I BUXHETIT.....		16

1 Informacion i Përgjithshëm

Ky dokument ofron informacionin e nevojshëm për paraqitjen e projekt propozimeve bazuar në thirrjen e parë për projekte kërkimore të financuara nga buxheti i Universitetit të Tiranës. Gjithashtu, paraqet kornizën e përgjithshme të bashkëpunimit dhe detajon procedurat për dorëzimin e aplikimeve.

Universiteti i Tiranës në kuadër të misionit të tij për mbështetjen e kërkimit shkencor shpall Thirrjen për Aplikime në programin “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION” ku ftohen personel akademik me kohë të plotë, të cilët janë të interesuar të angazhohen për të kontribuar në fushat dhe prioritetet e vendosura nga Njësitë Kryesore/Bazë.

Thirrja për Aplikime do të qëndrojë e hapur prej datës **06 Shtator 2021** deri më **15 Tetor 2021 ora 17:00!**

Nën këtë thirrje të gjithë aplikantët duhet të depozitojnë dokumentet e mëposhtme në rrugë elektronike në adresën: kerkimshkencor@unitir.edu.al

Afati maksimal i zbatimit të projektit është 24 muaj, por zgjatjet pa kosto mund të lejohen me paraqitjen e justifikimit të duhur.

2 Qëllimi dhe Objektivat e Programit “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”

Qëllimi i Programit “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion” është të mbështesë personelin akademik me kohë të plotë në realizimin e objektivave kërkimore konkurruese duke mbështetur nxjerrjen e të dhënave paraprake, me synimin e vendosjes së bashkëpunimeve të reja në të ardhmen.

Objektivat e këtij programi janë:

- Të mbështesë personelin akademik me kohë të plotë në fushat specifike të kërkimit për gjenerimin e të dhënave shkencore të besueshme dhe konkurruese në treg, të cilat do të shërbejnë si bazë për aplikime të mëtejshme edhe në aplikimet ndërkombëtare.
- Të mbështesë personelin akademik me kohë të plotë për zhvillimin e projekteve të tyre kërkimore dhe krijimin e kushteve për përparimin në karrierë.
- Të mbështesë Njësinë Kryesore dhe Njësinë Bazë për zgjerimin e fushës së tyre të kërkimit dhe inovacionit në përputhje me strategjinë kërkimit shkencor të UT-së dhe nevojave të tregut, si dhe për të përcaktuar realizueshmërinë e projektit me qëllim sigurimin e të dhënave paraprake për të mbështetur aplikimet për financime jashtë universitetit.
- Të mbështesë me fonde kërkimet strategjike të cilat përmbushin nevojat dhe prioritetet e UT-së.
-

3 Kriteret e Aplikimit

- ✓ Përmbajtja dhe objektivat e projektit duhet të jenë në përputhje me misionin dhe fushat e veprimtarisë së UT-së, Strategjisë Kombëtare për Kërkimin dhe Inovacionin, Planit të Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës 2018-2022, si dhe Fushave kërkimore të Njësive Bazë përkatëse.
- ✓ Projektet propozimet nën këtë thirrje duhet të jenë projekte kërkimore lokale/ kombëtare që i përkasin fushave të përcaktuara nga njësia bazë sipas nenit 114 pika 3 të Statutit të Universitetit të Tiranës. Njësia Bazë çdo fillim viti akademik përcakton fushat, drejtimet, veprimtarisë kërkimore shkencore.
- ✓ Projekt propozimet duhet të dorëzohen nga një ekip i përbërë nga të paktën tre pedagogë me kohë të plotë brenda Universitetit të Tiranës/ Njësive Kryesore/Njësive Bazë dhe minimalisht një student doktrate. Përbën avantazh prania edhe e një anëtari nga universitete të huaja si bashkëpunëtor.
- ✓ Ekipi i punës kërkimore duhet të caktojë një udhëheqës shkencor të projektit që do të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e projektit.
- ✓ Udhëheqësi shkencor duhet të ketë të paktën gradën shkencore Doktor.
- ✓ Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë ka të drejtë të marrë pjesë në këtë thirrje me kushtin që projekt propozimi të jetë në përputhje me objektin e veprimtarisë së njësisë/ve bazë/kryesore ku bën/bëjnë pjesë ekipi i punës i propozuar në projekt.
- ✓ Në këtë thirrje për propozime anëtarët e ekipit mund të dërgojnë vetëm një propozim.
- ✓ Inkurajohen projektet që mbështesin nisma ndërdisiplinore dhe që mund të sigurojnë perspektiva për bashkëpunim në të ardhmen për thirrje të tjera kombëtare apo ndërkombëtare dhe projektet të cilat mbështesin kërkimet doktorale.

4 Financimi dhe Udhëzime mbi Buxhetin

Financimi i dhënë nga Universiteti i Tiranës ndryshon në varësi të madhësisë dhe qëllimit të projekteve, si edhe buxhetit vjetor të përcaktuar për programin e “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”. Kufiri maksimal i financimit për një projekt propozim është *1 000 000 ALL*.

Fondi total në kuadër të kësaj thirrje është 10 000 000 ALL. Shumë e siguruar nga një pjesë e transfertës së ardhur nga MASR për kërkimin shkencor.

Një zgjatje pa kosto duhet të miratohet nga Rektori i Universitetit. Kërkesat për një zgjatje pa kosto duhet të bëhen para afatit të përfundimit të shënuar në projekt propozim. Zgjatjet, në çdo rast, do të bëhen deri në 6 muaj.

Fondet duhet të përdoren vetëm për të mbuluar shpenzimet që janë të përcaktuara në projekt propozim. Zërat e shpenzimeve duhet të jenë në përputhje me natyrën e kërkimit shkencor.

Shpenzime të lejuara

- ✓ **Honorare për pagesat e stafit** të angazhuar në projekte deri në masën 50%. Njësia matëse do të jetë me orë pune. Vlera e një ore pune do të jetë paga orare mesatare e vit paraardhës;
- ✓ **Shpenzime për blerje pajisje.** Kjo kategori mund të lejohet për financim me miratim paraprak dhe duke paraqitur argumentin përkatës për nevojën e pajisjeve dhe domosdoshmërinë e tyre në aktivitetet e projektit.
- ✓ **Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit** për kërkuesit me qëllim përmbushjen e objektivave specifike të projektit.
- ✓ **Blerje e literaturës shkencore.** Zërat e lejuara nën këtë kategori janë literaturë shkencore dhe materiale referuese, libra etj.
- ✓ **Shpenzime të tjera** si p.sh kostot e publikimit të dorëshkrimeve shkencore dhe artikujve shkencorë produkt i projekteve në revista shkencore të fushavë përkatëse, reagent (materiale).

Shpenzime të palejuara

- ✎ Mirëmbajtja infrastrukturore
- ✎ Kostoja e ndërtimit të ndërtesave të reja ose ndryshimet dhe modifikimet e ndërtesave dhe mjediseve ekzistuese;
- ✎ Shpenzimet normale administrative dhe të përgjithshme të Institucionit;
- ✎ Tarifat bankare;
- ✎ Shpenzime sekretarie;
- ✎ Marrja me qira e pajisjeve kapitale, ambjenteve etj.

Pajisjet, materialet, literatura e blerë për projektin përmes financimit nga programi i “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion” duhet të mbeten pronësi e Njësive Kryesore pas përfundimit të afatit të zbatimit të projektit.

Çdo financim tjetër i nevojshëm për zbatimin e projekteve duhet të sigurohet siaps rastit nga burime të tjera financimi.

Publikimet apo produkte të tjera që do të rezultojnë nga kërkimi duhet të deklarohen se janë financuar nga programi “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”.

5 Afati i Aplikimit dhe Dorëzimi

Kalendari i Thirrjes	
06 Shtator 2021	Hapja e thirrjes për projekte
15 Tetor 2021	Afati i fundit për dorëzimin e projekt propozimeve
18-22 Tetor 2021	Shqyrtimi nëse projekt propozimet janë në përputhje me kriteret e thirrjes nga Drejtoria e Projekteve pranë UT-së
25 Tetor -10 Nëntor 2021	Vlerësimi i projekt propozimeve nga Komisioni Institucional i UT
12 Nëntor 2021	Publikimi i rezultateve
15 Nëntor 2021	Paraqitja e ankesave për procesin e vlerësimit
17 Nëntor 2021	Analizimi i ankesave dhe publikimi i rezultateve përfundimtare
01 Dhjetor 2021	Nënshkrimi i kontratave / marrëveshjeve dhe fillimi i zbatimeve i projekteve të miratuara

Kandidatët duhet të dorëzojnë me email në adresat kerkimshkencor@unitir.edu.al dokumentat e mëposhtëm

- Aneksi 1- Formularin e projekt-propozimit të plotë;
- Aneksi 2- Formularin e buxhetit;
- Aneksi 3- Arsyetimi i buxhetit
- CV-të e ekipit të kërkimit që është propozuar për t'u angazhuar në projekt-propozim.

Gjatë periudhës që thirrja do të qëndrojë e hapur, Universiteti i Tiranës do të organizojë një sesion informues.

Për çdo informacion apo paqartësi ju lutem na shkruani në: kerkimshkencor@unitir.edu.al

6 Procedurat e Përzgjedhjes dhe Kriteret e Vlerësimit

Projektit kërkimor dhe buxheti i tij do i nënshtrohen procesit të vlerësimit . Me qëllim sigurimin e cilësisë në projekte kërkimore dhe ruajtjen e të njëjtit standard vlerësimi, përzgjedhje e projekt propozimeve fituese që përmbushim kriteret për financim do të realizohet nga një komision vlerësimi i ngritur në nivel institucional i cili do të jetë i përbërë nga ekspertë (9 ose 11) më të mirë të fushës specifike (stafi aktual i UT-së) dhe disa ekspertë të pavarur. Përbërja e këtij komisioni vlerësimi miratohet nga Rektorati i UT-së. Ekspertët e pavarur do të përzgjidhen pas një thirrje të hapur të dedikuar për ekspertë vlerësues të shkrimit të projektit (preferohen pedagogë nga universitete të huaj ose vendase, ish studentë të UT-së që sot janë staf i IAL-ve në botë ose ekspertë me eksperiencë në fushën e shkrimit, vlerësimit dhe menaxhimit të projekteve/kërkimore shkencore).

Komisioni i vlerësimit në nivel institucional do të shqyrtojë projekt propozimeve bazuar në kriteret e mëposhtme. Lista e projekteve të shpallura fituese nga programi “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion” do të publikohen në faqet zyrtare të UT dhe njësive kryesore.

Përzgjedhja do të bëhet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- ✓ Cilësia shkencore e projekt propozimit;
- ✓ Rëndësia shkencore/ krijuese. Mundësia që projekt propozim të ketë ndikim të rëndësishëm në fushën e kërkimit të propozuar, si edhe përputhshmëria me prioritet e zhvillimit kombëtar;
- ✓ Zbatueshmëria e planit të punës;
- ✓ Përshtatshmëria e metodologjisë dhe analizës së të dhënave;
- ✓ Cilësia dhe ekspertiza e ekipit kërkimor në fushën e projektit;
- ✓ Harmonizimi logjik i aktiviteteve dhe justifikimi i duhur në buxhet;
- ✓ Perspektivat për zhvillimin e një bashkëpunimi të ardhshëm jashtë Universitetit apo në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian;
- ✓ Mundësia për të siguruar bashkëpunim të ri ndërdisiplinor që më pas pritet të sigurojë mbështetje me fonde kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare.

<i>Kriteret e vlerësimit</i>	Pikët maksimale	Pikët minimale
<i>Cilësia shkencore e projekt propozimit</i> Rëndësia dhe vështirësitë e temës së trajtuar dhe objektivat e propozuara; origjinaliteti i zgjidhjeve të propozuara; metodologjia dhe plani i punës; përputhshmëria me fushat e kërkimit të Njësisë bazë dhe me Planin e Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës 2018-2022	35	N/A
<i>Cilësia dhe ekspertiza e ekipit kërkimor në fushën e projektit</i> ekspertiza shkencore e drejtuesit të projektit dhe ekipit të projektit; botimet e stafit akademik përfshirë në projekte të tjera kërkimore në fushën e kërkimit të propozuar, në revista me faktor impakti	30	N/A
<i>Harmonizimi i aktiviteteve të planifikuara në projekt</i> harmonizimi e ekipeve kërkimore (kontributet e ndërsjella, shpërndarja e ekuilibruar e detyrave, ndërdisiplinariteti); vlera e shtuar e bashkëpunimit; përfshirja e kërkuesve të rinj, doktorantëve dhe e studentëve.	10	N/A
<i>Efikasiteti</i> Harmonizimi logjik i aktiviteteve dhe justifikimi i duhur në buxhet	10	N/A
<i>Perspektivat për zhvillimin e bashkëpunimeve të ardhshme jashtë Universitetit apo të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian apo projekte të tjera kërkimi ndërkombëtare.</i> Perspektivat për bashkëpunim në të ardhmen: paraqitja e një projekt ideje në të ardhmen në thirrjet H2020-European Green Deal apo projekte të tjera ndërkombëtare etj.	15	N/A
<i>Totali</i>	100	70
Vetëm projekt propozimet që kanë marrë të paktën 70 pikë do të mbështeten për financim.		

7 Zbatimi dhe Monitorimi i Projekteve

Fondet për projektet e miratuara do të lëvrohen pas nënshkrimit të kontratës së financimit ndërmjet ekipit të kërkuesve të parashikuar në projekt propozim dhe Administratorit të UT-së.

Gjatë zbatimit të projektit, ekipit të kërkuesve do t'u kërkohet çdo gjashtë muaj një raport i ndërmjetëm shkencor dhe financiar. Ndërsa në fund të projektit një raport përfundimtar shkencor dhe financiar. Raportet duhen hartuar në përputhje me udhëzimet e komunikuara nga Drejtoria e Projekteve dhe Drejtoria e Financës pranë Universitetit të Tiranës.

Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve do të kryhet nga komisioni i vlerësimit në nivel institucional në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve dhe Drejtorinë e Financës pranë Universitetit të Tiranës.

Pas përfundimit të projektit, ekipi i kërkuesve inkurajohet t'i përgjigjen thirrjeve ndërkombëtare në kuadër të programeve të BE-së apo programeve të tjera të kërkimit.

Aneksat - eform

Aneksi 1: FORMULARI I APLIKIMIT NË PROGRAMIN “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION”

Ju lutemi respektoni rregullat e mëposhtme të formatimit: Times Neë Roman, madhësia e shkronjave 12, kufijtë e fletës (2.0 cm anë dhe 1.5 cm lart dhe poshtë), hapësira mes rreshtave një.

Projekti

Titulli i Projektit:		
Referenca e projektit: (të plotësohet nga Drejtoria e Projekteve pranë Rektoratit) (p.sh FHF/...)	Viti Financiar:	Shuma në lekë për vitin 2021:
Kohëzgjatja e Projektit:... muaj, Data e fillimit:		Shuma totale : (Nëse projekti është më i gjatë se një vit)

Aftësitë dhe ekspertiza e stafit të përfshirë në projekt

(Të specifikohen emrat e ekipit të kërkuesve të projektit dhe të përshkruhet ekspertiza e secilit anëtar të ekipit në lidhje me zbatimin e projektit dhe rolin që do të ketë secili prej tyre në projekt. Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet cilësisë së profilit akademik të secilit anëtar të ekipit në fushën specifike të propozuar në projekt propozim. Arsyetoni përse ky ekip i ngritur është i rëndësishëm në kryerjen e kërkimit. Rekomandohen 2500 karaktere)

Emër Mbiemër	Përmbledhje e aftësive dhe e përvojave (deri në 350 fjalë- BIO)	Roli në projekt (Udhëheqës/ Bashkëpunëtor/Personel tjetër)

Personel akademik i projektit (Udhëheqësi i Projektit)

Titulli/ Grada		Data e fitimit së titullit/ gradës:
Emër Mbiemër		Gjinia <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> M
Njësia Bazë/ Njësia Kryesore		
Telefon		
Email		

Personel akademik i projektit (Bashkëpunëtorët)

(Ju lutem shtoni tabela aq sa të jetë e nevojshme për çdo personel të stafit të projektit)

Titulli/ Grada		Data e fitimit së titullit/ gradës:
-----------------------	--	-------------------------------------

Emër Mbiemër		Gjinia <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> M
Departamenti/ Fakulteti		
Telefon		
Email		

PROFILI AKADEMIK I EKIPIT TË PROJEKTIT

Duhet të sigurohet informacioni i mëposhtëm për secilin anëtar të ekipit të projektit, duke përfshirë udhëheqësin e projektit:

- Një Curriculum Vitae (të përdoret modeli Europass; <https://europa.eu/europass/en/create-europass-cv>)
- Një listë e publikimeve më të rëndësishme (titulli dhe 2- 3 abstrakte të cilat lidhen me drejtimin ku propozohet projekti / përmbledhje e shkurtër për secilin botim, përfshirë vitin e botimit dhe për artikujt, emrin e revistës në të cilën është botuar artikulli, ISBN/ISSN). Ky informacion duhet të plotësohet në Tabelën 1: Model i listës së publikimeve.
- Një listë e përvojave më të rëndësishme / të fundit në projekte (titulli dhe një përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së objektivave të secilit projekt, vitin në të cilin është zbatuar projekti, disa nga aktivitetet e realizuara dhe rolin tuaj në këto projekte) Ky informacion duhet të plotësohet në Tabela 2: Model i listës së projekteve të mëparshme ku personeli akademik ka marrë pjesë.

Tabela 1: Model i listës së publikimeve

Për çdo anëtar të ekipit të projektit duhet plotësuar tabela e listës së publikimeve.

Të listohen publikimet më të rëndësishme (titulli dhe një abstrakt / përmbledhje e shkurtër për secilin publikim, përfshirë vitin e botimit dhe për artikujt, emrin e revistës në të cilën është botuar artikulli). Të shtohen rreshtat e nevojshëm për të paraqitur informacionin deri në 6 publikime.

Emër Mbiemër	
Titulli i publikimit nr. 1.	
Viti i Botimit:	
Abstrakt (deri në 1000 karaktere):	
ISBN/ISSN	
Titulli i Revistës	
Faktor Impakti (nëse ka)	
Titulli i publikimit nr. 2.	
Viti i Botimit:	
Abstrakt (deri në 1000 karaktere):	
ISBN/ISSN	
Titulli i Revistës	

Faktor Impakti (nëse ka)	
---------------------------------	--

<p>Tabela 2: Model i listës së projekteve të mëparshme ku personeli akademik ka marrë pjesë</p> <p><i>Për çdo anëtar të ekipit të projektit plotësoni përvojat në projekte të tjera.</i></p> <p><i>Informacioni që nevojitet për çdo projekt: titulli dhe një përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së objektivave të secilit projekt, vitin në të cilin është zbatuar projekti, disa nga aktivitetet e realizuara dhe rolin tuaj në projekt).</i></p> <p><i>Të shtohen rreshtat e nevojshëm për të paraqitur informacionin për pjesëmarrje në projekte të tjera kërkimore për secilin anëtar të personelit të projektit deri në 4 projekte.</i></p>	
Emër Mbiemër	
Titulli i projektit nr. 1.	
Viti i zbatimit të projektit:	
Përshkrim i shkurtër i projektit, objektivave dhe aktiviteteve të realizuara (deri në 1500 karaktere):	
Ekspertiza juaj në këtë projekt (Roli që keni pasur)	

Përmbledhja e Projekt Propozimit

(Jepni një përmbledhje të projekt propozimit, për t'u kuptuar nga një audiencë jo-akademike. Shpjegoni kontekstin e kërkimit, qëllimet dhe objektivat e tij, duke përfshirë edhe përfitimet e mundshme në të ardhmen. Në rast të financimit të projekt idesë tuaj kjo pjesë do të publikohet në faqen e internetit të Njësisë Kryesore/Universitetit të Tiranës. Rekomandohen 2000 karaktere).

Abstrakti

(Paraqisni një përmbledhje shkencore të projekt propozimit tuaj kërkimor. Shkurtimisht përshkruani objektivat, grupet e synuara, aktivitetet kryesore dhe rezultatet e parashikuara të projektit. Rekomandohen 3000 karaktere)

Analiza e kontekstit

(Përshkruani historikun e problemit duke theksuar pyetjen(t)/hipotezat që dëshironi të adresoni. Cilësoni punime, ose publikime shkencore, të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë, që përbëjnë bazën mbi të cilën ngrihet argumentimi praktik ose shkencor i projektit. Përcaktoni qartë qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata të kërkimit. Specifikoni lidhjen e propozimit me objektivat specifike të fushave të veprimit të propozuara nga Njësia Bazë apo Njësia Kryesore. Përshkruani karakteri inovativ dhe ndërdisiplinor të projekt propozimit. Rekomandohen 10 000 karaktere)

Analiza e grupeve të synuara dhe e palëve të interesit nga projekti

(Identifikoni dhe rendisni përfituesit dhe nevojat e tyre. Shpjegoni se si objektivat specifike të projektit dhe aktivitetet e parashikuara në projekt do të adresojnë nevojat e përfituesve. Përshkruani se si do të arrihen dhe përfshihen grupet e synuara gjatë gjithë jetës së projektit dhe se si grupet e synuara do të përfitojnë nga ky projekt brenda institucionit, në nivel lokal apo kombëtar. Rekomandohen 4000 karaktere)

Rezultatet e pritshme

(Përshkruani rezultatet e parashikuara shkencore, përfitimet për grupet e synuara për hulumtimin e propozuar brenda institucionit, në nivel lokal apo kombëtar. Shpjegoni se si objektivat specifike të projektit dhe aktivitetet e parashikuara në projekt do të adresojnë nevojat e grupeve të synuara. Rekomandohen 4000 karaktere)

Plani i punës, përfshirë metodologjinë dhe teknikat që propozohen të përdoren

(Të përshkruhet se si është konceptuar plani i punës në lidhje me aktivitetet e propozuara duke përmendur fazën e përgatitjes, zbatimit, vlerësimin, fazën e ndjekjes mbas përfundimit të projektit dhe informimin mbi kërkimin. Shpjegoni me kujdes se si do të arrihen rezultatet e aktiviteteve të projektit (output) duke ju referuar edhe buxhetit të propozuar. Si do të arrihen rezultatet e projektit (outcome) dhe cili do të jetë ndikimi shkencor / teknologjik i projektit në fushën kërkimore të adresuar Rekomandohen 8000 karaktere)

Aktivitetet e projektit

(Të përshkruhen aktivitetet e ndryshme që synohen të realizohen. Për çdo aktivitet specifik ju lutem shtoni tabelat që nevojiten).

Aktiviteti Nr.	
Titulli i aktivitetit	
Jepni përshkrimin e aktivitetit të projektit dhe rëndësinë e tij në drejtim të arritjes së objektivave <i>(Rekomandohen 2000 karaktere)</i>	
Ndikimi <i>(ndikimi shkencor / teknologjik i projektit në fushën kërkimore të adresuar; ndikimi i pritur arsimor dhe / ose ekonomik, ndikimi në mjedis, etj.)</i>	
Metodologjia	
Grupi i synuar	
Periudha e realizimit të aktivitetit	
Si do të realizohet vlerësimi i brendshëm i cilësisë së kërkimit? Si do të ndiqet zbatimi i projektit dhe verifikimi i rezultateve të tij (output)?	

Matrica e kornizës logjike

Objektivi i përgjithshëm i projektit	Treguesit kryesorë të lidhur me arritjen e objektivit të përgjithshëm <i>(Tregues sasior dhe cilësor që matin realizimin e objektivit të përgjithshëm të projektit)</i>	Si do të maten këto tregues?		
Objektivat specifikë të projektit	Treguesit kryesorë të lidhur me arritjen e objektivave specifike <i>(Tregues sasior dhe cilësor që matin realizimin e objektivave specifike të projektit)</i>	Si do të maten këto tregues?	Supozimet dhe Rreziqet <i>(Faktorët jo në kontroll direkt të projektit që mund të ndikojnë arritjen e objektivave)</i>	Si do të zbuten apo kontrollohen këto rreziqe?

Metodologjia

(Ju lutemi përcaktoni metodologjinë e punës të propozuar për arritjen e objektivave të propozimit. Identifikoni qartë metodat që do të përdoren dhe ekspertizën tuaj me to. Rekomandohen 3000 karaktere).

Analiza e riskut

(Rendisni risqet që mund të ndikojnë negativisht në arritjen e rezultateve. Përqendrohuni në risqet që mund të parandaloni ose menaxhoni? Për secilin risk të identifikuar, shpjegoni shkurtimisht pasojat dhe jepni një plan veprimi. Rekomandohet 2500 karaktere)

Kontrolli i cilësisë dhe monitorimi

(Shpjegoni se çfarë mekanizmash do të vendosen për të siguruar cilësinë e kërkimit dhe si do të kryhet vlerësimi i rezultateve të aktiviteteve kërkimore. Rekomandohen 2000 karaktere)

Strategjia e informimit mbi kërkimin

(Përshkruani se si do të shpërndahet kërkimi përtej Universitetit të Tiranës. Kjo mund të përfshijë metoda të tilla si botimet, aktivitete akademike dhe publike, transferimin e njohurive tek përdoruesit përfundimtarë, krijimin e rrjeteve, etj. Rekomandohet 2500 karaktere)

Perspektivat e bashkëpunimit

(A po kërkoni financim nga Programi i UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion për të përgatitur një projekt ide kërkimi në të ardhmen për një financim nga jashtë Universitetit të Tiranës? Ju lutem përshkruani një plan për dorëzimin e një projekt ideje në të ardhmen në një financues jashtë Universitetit të Tiranës. Ju lutemi jepni emrin e kompanisë/institucionit/fondit, mundësinë e parashikuar të financimit dhe kohën e dorëzimit të projekt idesë, dhe detaje se si ky projekt do të forcojë aplikimin. Rekomandohen 3000 karaktere)

Referencat

Aneksi 2: FORMULARI I BUXHETIT

Kontributi financiar i kërkuar nga programi "UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION" (të gjitha shifrat të shprehen në Lekë)

Ju lutemi lexoni me kujdes Udhëzimet e Buxhetit dhe jepni ndarjet vjetore, në lekë, të fondeve të kërkuara, së bashku me një përshkrim të shkurtër të shpenzimeve të parashikuara.

Zërat e buxhetit	Viti i parë	Viti i dytë	Totali i buxhetit për çdo zë
Paga			
Pajisje			
Artikuj konsumi			
Shpenzimi udhëtimi dhe qëndrimi			
Literaturë			
Shpenzime të tjera			
Totali			

KONTRIBUTI TOTAL I KËRKUAR NGA PROGRAMI "UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION"
_____ LEKË

(Kontributi maksimal i kërkuar nuk mund të kalojë 1 000 000 Lekë)

Aneksi 3 ARSYETIMI I BUXHETIT

(Pse janë këto shpenzime të nevojshme për të kryer kërkimin? Jepni informacion të hollësishëm për secilin nga zërat e parashikuara në buxhetin tuaj. Referojuni udhëzimeve për shpenzimet e lejuara dhe të pa lejuara. Rekomandohen 3000 karaktere)

Pagat e kërkuesve

Ky zë i buxhetit nuk duhet të kalojë 50% të totalit të fondit të kërkuar. Ju lutem paraqisni një justifikim për secilën nga zërat e parashikuara nën këtë kategori për t'u financuar nga programi i "UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion"

Nr	Zëri i buxhetit <u>Pagat e kërkuesve</u>	<u>Justifikimi</u>
<u>1</u>		
<u>2</u>		
<u>3</u>		
<u>4</u>		

Blerje e artikujve të konsumit; Blerje e pajisjeve standarde kërkimore; Blerje e softuerëve dhe e patentave

Ky zë i buxhetit nuk duhet të kalojë 20% të totalit të fondit të kërkuar. Ju lutem paraqisni një justifikim për secilën nga zërat e parashikuara nën këtë kategori për t'u financuar nga programi i "UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion"

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.

Shpenzime Udhëtimi dhe Qëndrimi

Kjo kategori e buxhetit nuk duhet të kalojë 20% të totalit të fondit të kërkuar. Ju lutem paraqisni një justifikim për secilën nga zërat e parashikuara nën këtë kategori për t'u financuar nga programi i "UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion"

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.

Literatura

Kjo kategori e buxhetit nuk duhet të kalojë 5% të totalit të fondit të kërkuar. Ju lutem paraqisni një justifikim për secilën nga zërat e parashikuara nën këtë kategori për t'u financuar nga programi i "UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion"

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.

Shpenzime të tjera- Kjo kategori e buxhetit nuk duhet të kalojë 5% të totalit të fondit të kërkuar. Ju lutem paraqisni një justifikim për secilën nga zërat e parashikuara nën këtë kategori për t'u financuar nga programi i "UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion"

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.